



Posta e Kosovës Sh. A.

FILATELIA E POSTËS SË KOSOVËS RISHPALL KONKURSIN GARUES

Për dizajne artistike të motiveve për pulla postare për temën Trashëgimia kulturore – “Objekti i ish Bankosit” dhe “Rruga e Marin Barletit-Prizren” nga programi i rregullt vjetor për vitin 2026.

1.Tema e emisionit: Trashëgimia kulturore “Objekti i ish Bankosit” dhe “Rruga e Marin Barletit-Prizren”.

Përshkrimi: Paraqitja artistike e objektit të ish Bankosit në Pejë, si dhe të rrugës “Marin Barleti” në Prizren në forma artistike: pikturë, fotografi artistike, grafikë, etj.

Shpërblimet: Vendi i parë për pullë postare €300, vendi i dytë për pullë postare €250.

RREGULLAT E KONKURRIMIT:

1. Dizajnet artistike (vizatim, pikturë, grafikë, fotografi artistike) të bazuara në këto tema duhet të punohen në programe të specializuara për dizajn si Adobe Photoshop, Illustrator, Corel Draw. Të njëjtat duhet të dorëzohen të shtypura për nevoja të vlerësimit të komisionit, si dhe në fajll kompjuterik.
Punimet me rezolucion më të ultë se **500 px**. (TIFF, JPG ose PDF) nuk pranohen.
2. Për shkaqe të konfidencialitetit dhe objektivitetit, emri i autorit të dizajnit nuk duhet të shënohet pranë motivit konkurrues, aty duhet të shënohet vetëm shifra konkurruese, ndërkaq shënimet për autorin duhet të jenë të mbyllura në pliko të veçantë brenda plikos me punime konkurruese.
3. Komisioni i Pullës Postare, gjatë përzgjedhjes së dizajnëve, nuk do të ketë qasje në shënime autoriale, por ka të drejtë të kërkojë verifikimin e origjinalitetit të dizajnëve potencialisht të përzgjedhur.
4. Dizajnet konkurruese për këtë konkurs duhet të dorëzohen në zarfe të mbyllura, duke shënuar temën/emisionin për të cilin konkurroni dhe shifrën konkurruese.
5. Një autor mund të konkurrojë me numër të pacaktuar të punimeve apo shifrave konkurruese brenda një teme.
6. Përgjegjësinë për të drejtat autoriale e bart autori i dizajnit (konkurruesi).
7. Bazuar në: LIGJIN Nr. 04/L-065 PËR TË DREJTAT E AUTORIT DHE TË DREJTAT E PËRAFËRTA, autori fitues me dizajne të huazuara duhet patjetër të posedojë autorizimin me shkrim ose me e-mail nga autori i veprës origjinale, të cilën mund t’ia bashkëngjitë punimeve konkurruese ose ta dërgojë të skanuar në e-mail adresën: filatelia@postakosoves.com dhe ta sjellë në “hard copy” në Zyrën e Filatelisë.
8. PK Sh.A., mban të drejtën e përdorimit të dizajnit në motive të pullave postare ZDP, VDP, si dhe në produkte filatelike të ndërlidhura me pulla postare dhe shërbim postar.
9. Vlera e shpërblimeve për dizajne fituese është paraqitur si vlerë bruto.

Për hir të objektivitetit dhe detajeve konfidenciale, në pjesën e jashtme të zarfit duhet të shkruhet vetëm kodi i zgjedhur nga autori (pranë punimeve konkurruese nuk duhet të shfaqet emri dhe mbiemri i autorit, vetëm kodi i zgjedhur).

Komisioni për Pullat Postare, me rastin e zgjedhjes së një dizajni, nuk do të ketë qasje në të dhënat personale të autorit të dizajnit, por ka të drejtë të kontrollojë origjinalin e dizajneve të zgjedhura potencialisht.

KONKURSI do të jetë i hapur prej datës: 13.07.2026 deri më: 24.07.2026 dhe do të jetë i publikuar në ueb faqen: www.postakosoves.com.

Punimet konkurruese nuk do t'iu kthehen autorëve.

Zgjedhjen e punimeve më të mira konkurruese, duke u bazuar në dizajnin më të mirë dhe ndarjen e shpërblimeve, do ta bëjë Komisioni i Pullës Postare.

Punimet konkurruese mund t'i dorëzoni në Arkivin qendror të Postës së Kosovës apo t'i dërgoni përmes letërdërgesave nga çdo zyrë postare në adresën:

Ndërtesa kryesore e Postës së Kosovës

Arkivi qendror/ Për Konkurs-Filateli

Rr."28 Nëntori" nr. 4 Dardani

10000 Prishtinë

Për informata shtesë mund të thërrisni në numrin e telefonit: **+383(0)38 246 770**, apo të drejtoheni në e-mail adresën: filatelia@postakosoves.com ose në ueb faqen zyrtare: www.postakosoves.com.

**Nora Rraci**
Kryeshefe Ekzekutive e PK Sh.A.